

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Lumni Sallauka- kryetar i kolegjit, Rafet Haxhaj dhe Burim Shala, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses L.G. nga Prishtina, rr.“...” nr., kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme-Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson F.A., zyrtare e lartë ligjore, me objekt të padisë anulimin e vendimit për masën disiplinore-suspendim nga puna pa pagesë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.385/11, i datës 24.09.2013, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 16.07.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditëses L.G. nga Prishtina, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.385/11, i datës 24.09.2013, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.385/11, të datës 24.09.2013, në pikën I të dispozitivit e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditëses L.G. nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, me numër 67, i datës 02.02.2011 dhe të obligohet e paditura që paditëses, në emër të pagave të pa paguara për periudhën nga data 14.02.2011 e deri me datën 14.04.2011, t’ia paguajë pagën nga 441.46 euro në muaj, ndërsa në pikën II të dispozitivit ka vendosur që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësja, pa i cekur bazat ligjore, me propozim që gjykata e shkallës së dytë të aprovoj si të bazuar ankesën dhe aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë dhe kërkesëpadia e paditëses, të aprovohet si e bazuar, ose aktgjykimin e atakuar ta anuloj, ashtu që të më liroj nga përgjegjësia.

Përgjigje në ankesë nuk ka pasur.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesa e paditëses është **e pa bazuar**.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja, me datën 24.02.2011, ka ushtruar padi ndaj të paditurës, me kërkesë që të anulohet vendimi i Ministrisë së Punëve të Brendshme, si i pa bazë dhe i padrejtë dhe paditësja të kthehet në vendin e punës, t’i kompenzohen paditëses të gjitha të ardhurat mujore-personale, që nga data e parë e suspendimit 14.02.2011, e deri në datën e rifillimit të punës, detyrohet e paditura që

t'i paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës gjyqësore dhe taksat eventuale, e të gjitha këto në afat të caktuar ligjor, nën kanosje të ekzekutimit të dhunshëm.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.385/2011, i datës 24.09.2013, me të cilin e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se kërkesëpadia e paditëses për anulimin e vendimit për masën disiplinore suspendim pa pagesë për 60 ditë, është e pa bazuar, për faktin se paditësja në padi dhe gjatë seancave gjyqësore ka deklaruar se prej datës 06.08.2009, e deri me datën 15.08.2009, ka qenë në pushim mjekësor dhe për këtë nuk ka informuar askënd ngase nuk ka pasur mundësi, duke pretenduar se të njëjtin fakt e kanë ditur policia, nga arsyet e paraqitura dhe provat e prezentuara ka pretenduar se vendimi i të paditurës është i kundërligjshëm ngase arsyeja pse ka munguar në punë nga data 09.08.2009 e deri me datën 13.08.2009, është se në këtë periudhë ka qenë e sëmurë dhe për këtë i ka ofruar prova të paditurës, por nuk janë marrë për bazë. E paditura në përgjigje në padi dhe gjatë seancave gjyqësore e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses duke theksuar se paditësja është shpall fajtorë për shkak se ka munguar në detyrë pa e njoftuar mbikqyrësin e saj apo ndonjë epror tjetër dhe duke mos bashkëpunuar me IPK, nuk i është përgjigjur ftesave për intervistë dhe me këtë veprim paditësja ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Policinë e Kosovës, neni 46 pika (b). Mbi bazën e të lartëcekurave, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se pala paditëse ka ofruar prova se gjatë kohës kontestuese ka qenë në pushim mjekësor, por nuk ka mundur të ofrojë dëshmi për të vërtetuar se për mungesën nga puna në këtë periudhë ta ketë njoftuar mbikqyrësin ose ndonjë person tjetër dhe t'iu ketë përgjigjur ftesave për intervistim nga Inspektorati Policor i Kosovës. Si rrjedhojë, ka vlerësuar se e paditura ka vepruar në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke respektuar edhe procedurën e paraparë disiplinore, kur ka vendosur ti shqiptojë masën disiplinore paditëses, anulimin e së cilës tani e kërkon paditësja. Ndërsa vendimit lidhur me shpenzimet procedurale gjykata ju ka referuar neni 450 të LPK-së.

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore të pretenduara, nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së dhe nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale, për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, si rezultat i sëcilën edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Gjithashtu edhe dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaftë i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për mos themelësinë e kërkesëpadisë, e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës paditëse se e paditura, përkatësisht zyrtarët policor të cilët kanë qenë në ndërrimin e njëjtë me paditësen, kanë qenë në dijeni se paditësja është në pushim mjekësor. Kjo për faktin se referuar shkresave të lëndës dhe provave të administruara nga gjykata e shkallës së parë, rezulton se paditësja me asnjë provë të vetme nuk ka arritur ti provojë këto pretendime. Në anën tjetër, rezulton se e paditura në tërësi ka zbatuar procedurën e paraparë disiplinore dhe drejtë ka zbatuar dispozitat e nenit 46 parag.1, pika b) të Ligjit për Policinë (Nr.03/L-0359, i cili ka qenë në fuqi në atë kohë), kur i ka shqiptuar paditëses masën disiplinore suspendim pa pagesë në periudhë prej 60 ditësh, për shkak të shkeljes disiplinore të paraparë me dispozitën e sipërcituar.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.992/14, datë 16.07.2018

Kryetari i kolegjit,
Lumni Sallauka, d.v